

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **70433736-26-5611-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me inventar**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	WOOD CORPORATION L.L.C.
NUI	811289562
Adresa	Rr.Ukë Bytyqi
Vendi	Suharekë
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Driton Gashi
Adresa elektronike	info@tenaseri.com
Data e parashtrimit të ankesës	20.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me inventar

Njoftimi për Kontratë për aktivitetin "Furnizim me inventar", me numër 70433736-26-5611-1-2-1 (numri i brendshëm KRUP-26-041-1-2-1). Vlera e parashikuar e kontratës publike kornizë, me kohëzgjatje 24 muaj, është 30,000.00 EUR.

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve dhe hapja e tenderëve kanë qenë më 20.08.2026, në orën 13:00. Kriteri i dhënies ishte tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. WOOD CORPORATION L.L.C. ka dorëzuar ofertë në vlerë 23,990.00 EUR. Më 31.08.2026, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin, me të cilin e ka anuluar aktivitetin pasi të tre ofertuesit janë vlerësuar të papërgjegjshëm, dhe në të njëjtën datë i ka dërguar WOOD CORPORATION L.L.C. letrën standarde të eliminimit.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për rishqyrtim e WOOD CORPORATION L.L.C.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik:

- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti;
- Neni 7 - Barazia në trajtim / mosdiskriminimi;
- Neni 54 - Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar;
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
- Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Udhëzuesi i Prokurimit Publik:

Pika 10.1 e Udhëzuesit nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

1. WOOD CORPORATION L.L.C. kundërshton Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrën standarde të eliminimit, të dyja të datës 31.08.2026, për pjesën me të cilën tenderi i tij është shpallur i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk janë dorëzuar “katalogje, manuale, broshura etj.”, si dhe anulimin që mbështetet në këtë eliminim.

2. Dosja e Tenderit, në pikën 3.1 të FDT-së, kërkon që operatori ekonomik të paraqesë deklaratën për specifikacionet teknike të mallrave të ofruara, të cilat përputhen me ato të Aneksit 1. Në pikat 9.1 dhe 9.2 kërkohet dokumentacion që përmban të dhënat teknike dhe dimensionet e inventarit, ndërsa si evidencë listohen “fleta me të dhëna teknike, katalogje, manuale, broshura, skica apo dokumente të tjera të lëshuara nga prodhuesi apo Operatori Ekonomik”. Pra, vetë Dosja përdor lidhëzën “apo” dhe parashikon disa forma alternative të dokumentimit pasi që katalogu nuk është emërtuar si forma e vetme dhe kumulative e provës.

3. Në ofertën e tij, WOOD CORPORATION L.L.C. ka dorëzuar Aneksin 1 - Specifikimet

Teknike të Detyrueshme, të nënshkruar dhe të vulosur. Përmes këtij dokumenti, OE ka pranuar dhe deklaruar specifikacionet teknike dhe dimensionet e mallrave të ofruara sipas kërkesave të AK-së. Kjo provë duhet të vlerësohet sipas përmbajtjes së saj dhe e përjashton faktikisht situatën në të cilën mungojnë edhe specifikacioni teknik, edhe katalogu. Duhet marrë parasysh se WOOD CORPORATION L.L.C. është vet prodhues i mobiljeve dhe me nënshkrimin e specifikacionit teknik ka marrë përsipër që ti prodhoj produktet sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

4. Letra e eliminimit nuk mohon dorëzimin e Aneksit 1 dhe nuk identifikon asnjë karakteristikë teknike konkrete që mungon, është e paplotë ose nuk përputhet me kërkesat. Ajo mbështetet vetëm në mungesën e katalogut dhe e barazon këtë situatë me mungesën e njëkohshme të specifikacionit teknik dhe katalogut. Ky barazim është faktikisht dhe juridikisht i gabuar.

5. Brenda afatit ligjor, WOOD CORPORATION L.L.C. ka dorëzuar Kërkesë për rishqyrtim brenda Autoritetit Kontraktues, por e njëjta është refuzuar si e pabazuar nga ana e Autoritetit Kontraktues i cili i ka qëndruar mbrapa arsyeve fillestare të eliminimit. Për këtë Autoriteti Kontraktues ka tentuar ta keqinterpretoj Udhëzuesin e Prokurimit Publik sipas situatës sikur të mos ishte dorëzuar asnjë specifikacion teknik.

II. BAZA LIGJORE PËR APROVIMIN E ANKESËS

Zbatim i gabuar i Udhëzuesit nr. 002/2024

6. Autoriteti Kontraktues në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ka cituar vetëm rastin e parë të tabelës në pikën 10.1 të Udhëzuesit nr. 002/2024: kur “mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu”, tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Kjo rregull nuk zbatohet ndaj ofertës së WOOD CORPORATION L.L.C., sepse specifikacioni teknik sipas Aneksit 1 është dorëzuar, nënshkruar dhe vulosur. Do të thotë nuk ka munguar as edhe një informacion i nevojshëm për të kërkuar sqarime sipas Nenit 72 të Ligjit.

7. Mirëpo, menjëherë pas atij rasti, në të njëjtën pikë dhe tabelë, Udhëzuesi rregullon shprehimisht situatën konkrete dhe më adekuate për këtë rast: “Është dorëzuar specifikacioni teknik për mallrat e ofruara por mungon katalogu” – “Mund të kërkohen informata sqaruese” (me referencë në nenin 69 të LPP-së). Autoriteti Kontraktues nuk mund ta zbatojë rregullin që kërkon mungesën e dy dokumenteve dhe ta injorojë rregullin e posaçëm për rastin kur specifikacioni është dorëzuar, por katalogu mungon. Norma e posaçme e Udhëzuesit përputhet saktësisht me gjendjen e ofertës së parashtruesit.

8. Vetë pika 10.1 sqaron se shembujt e tabelës nuk janë shterues dhe se Autoriteti Kontraktues, varësisht nga rasti, duhet të veprojë në përputhje me nenet 72 dhe 59 të Ligjit. Për rrjedhojë, arsyeja e përdorur në letrën e eliminimit jo vetëm që nuk mbështetet nga Udhëzuesi, por bie drejtpërdrejt ndesh me trajtimin që Udhëzuesi ia cakton kësaj situatë.

Sqarimi është i lejuar dhe nuk ndryshon një aspekt material të tenderit

9. Sipas nenit 72 të Ligjit, Autoriteti Kontraktues mund t'i ftojë operatorët ekonomikë të plotësojnë ose qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura sipas neneve 65-71. Kërkesa e diskutuar është vendosur pikërisht te “mundësitë teknike dhe/ose profesionale” dhe lidhet me nenin 69 të Ligjit. Edhe neni 59 paragrafi 2 lejon kërkesë me shkrim për sqarim të cilitdo aspekt të tenderit, me kusht që të mos kërkohet ose pranohet ndryshim material. Në rastin përkatës asnjë ndryshim nuk mund të bëhet, për arsye se WOOD CORPORATION L.L.C. i ka pranuar paraprakisht kushtet e përcaktuara në Aneksin 1.

10. Të njëjtën rrugull e ka inkuorporuar Autoriteti Kontraktues në pikën 29.1 të Dosjes së Tenderit për ta lehtësuar ekzaminimin dhe vlerësimin, AK mund të kërkojë sqarim dhe plotësim të dokumenteve të paraqitura sipas neneve 65-71, për aq sa informacioni ka qenë i fiksuar para afatit të dorëzimit dhe mund të verifikohet objektivisht. Katalogu ose fletët teknike, në këtë rast, duhet të shërbejnë vetëm për të konfirmuar karakteristikat e mallrave tashmë të deklaruara në Aneksin 1. WOOD CORPORATION L.L.C. nuk kërkon të ndryshojë produktet, çmimin, sasinë, dimensionet apo ndonjë element tjetër material të ofertës. Vlen të thuhet se mosdorëzimi i katalogut ka qenë vetëm lëshim teknik gjatë dorëzimit të ofertave dhe nuk ka pasur dhe nuk mund të ketë asnjë qëllim tjetër.

11. Nëse AK ka konsideruar se Aneksi 1 i dorëzuar nuk i mundëson verifikim të mjaftueshëm për ndonjë artikull, veprimi i ligjshëm ka qenë identifikimi i paqartësisë konkrete dhe kërkimi i katalogut, fletës teknike, skicës ose dokumentit tjetër sqarues për atë artikull. Eliminimi automatik, pa e përdorur këtë mekanizëm, e shndërron një mungesë të sqarueshme dokumentare në mungesë materiale të ofertës, në kundërshtim me nenet 59 dhe 72 dhe me udhëzimin specifik të KRPP-së.

Shkelja e praktikave të OSHP

12. Për më tepër, vendimi i Autoritetit Kontraktues për të eliminuar ofertën tonë vetëm për shkak të mosbashkëngjites fillestare të katalogut, bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me praktikën e konsoliduar të OSHP dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik. Neni 72 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ndërlidhur me Rregullat e Prokurimit, e udhëzon qartë Autoritetin Kontraktues që të kërkojë informacione dhe sqarime shtesë kur ka mungesa të natyrës informuese që nuk e ndryshojnë thelbin e ofertës.

13. Praktika e OSHP-së në raste analoge ka theksuar vazhdimisht se, në frymën e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe mbrojtjes së buxhetit publik, autoritetet kontraktuese nuk duhet të nxitojnë në eliminimin e menjëhershëm të operatorëve ekonomikë, për mungesa të tilla të rikuperueshme. Në këtë kontekst, mosshfrytëzimi i mekanizmit për kërkimin e sqarimeve shtesë e bën vendimin e AK të pabazë, pasi privon institucionin nga një ofertë e favorshme ekonomikisht dhe dëmton qëllimin e vetë ligjit për të maksimizuar vlerën e parasë publike.

14. Neni 59 paragrafi 4 lejon që tenderi të konsiderohet i përgjegjshëm kur ka vetëm paqartësi të korrigjueshme pa ndryshuar një kusht material ose devijime të vogla pa ndikim material. Duke mos sqaruar një dokument teknik tashmë të dorëzuar dhe duke anuluar tërë aktivitetin, AK ka vepruar në mënyrë formaliste dhe joproporcionale, duke cenuar përdorimin ekonomik dhe efikas të fondeve, konkurrencën dhe trajtimin e

barabartë sipas neneve 6 dhe 7 të LPP-së.

Duke u bazuar në faktet dhe dispozitat e mësipërme, WOOD CORPORATION L.L.C. i kërkon Organit Shqyrtues të Prokurimit që të nxjerr këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si të bazuar Ankesa e operatorit ekonomik WOOD CORPORATION LLC e paraqitur kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 31.08.2026.

II. ANULOHET Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 31.08.2026, në pjesën që eliminon WOOD CORPORATION L.L.C. dhe në pjesën që anulon aktivitetin mbi bazën e këtij eliminimi dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM.

III. DETYROHET Autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ta konstatojë dorëzimin e Aneksit 1 të nënshkruar dhe vulosur dhe, në përputhje me nenet 59, 69 dhe 72 të LPP-së, dhe pikën 10.1 të Udhëzuesit nr. 002/2024, t'i kërkojë WOOD CORPORATION LLC katalogun ose sqarimet e nevojshme vetëm për verifikimin e karakteristikave të mallrave tashmë të deklaruar, pa lejuar ndryshim material të tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N/a

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*